



Prishtinë: 12.07.2018
Kodi i ZRRE-së: V_1010_2018

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 9, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.7, nenin 15 dhe 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_V_1814_06_18**;
- Ankesa e KESCO-së e datës **06.07.2018**.

në seancën e mbajtur më datë 12.07.2018, nxori këtë:

V E N D I M

- I **REFUZOHET** ankesa e KESCO-së ndaj vendimit të DMK-së për konsumatorin A. M. (parashtruar nga B.K) nga Peja me shifër të konsumatorit: DPE – 9002114, si e pa bazuar.
- II **MBETET në fuqi** vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve nr. ZRRE/DMK_V_1814_06_18 i datës 08.06.2018

A r s y e t i m

Zyra e Rregullatorit për Energji me datë 04.06.2018 ka pranuar ankesën e parashtruar nga përfaqësuesi i autorizuar i KESCO-së, i cili ka kundërshtuar vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE si vendim i shkalës së parë për këto shkaqe: Përfaqësuesi i KESCO-së, në ankesë ka theksuar se në procesverbalin e inspektimit të datës 14.06.2017 është vërejtur se njehsori elektrik e ka të ndezur dritën e alarmit dhe dyshohet se ka ndërhyrje me magnet. Punëtorët e autorizuar të qendrës së kalibrimit kanë shqyrtuar njehsorin elektrik nr.16235105 dhe kanë konstatuar se njehsori elektrik është në rregull, njehsori nuk është i djegur, njehsori nuk ka dëmtime nga ana e jashtme, nuk ka probleme me sisteme matëse dhe është theksuar se njehsori e ka dritën e alarmit të ndezur. KESCO në ankesën e tyre kanë theksuar se pohimet e ZRRE/DMK se fatura e muajit 06/2017 mund të jetë si pasojë e ndonjë defektin matje, kjo nuk qëndron ngase kalibrimi ka theksuar se njehsori është brenda kufijve të lejuar të matjes, dhe duke theksuar se njehsori është ngacmuar me magnet, pra konsumatori ka keqpërdorur energjinë elektrike por pasi nuk dihet ndikimi i magnetit nuk ka bërë faturë të rikthimit të humbjeve. Gjithashtu KESCO ka theksuar se nëse krahasojmë shpenzimet e bëra me njehsor të ri menjëherë pas ndërrimit të njehsorit shihet se konsumatori ka shpenzim të konsiderueshëm. KESCO në ankesën e tyre kanë theksuar se kërkojnë nga Bordi i ZRRE-së që pezullojnë vendimin e DMK-së nr.ZRRE/DMK_V_1814_06_18 i datës 08.06.2018 për konsumatorin A. M. me shifër DPE - 9002114.

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji në mbledhjen e mbajtur me datë 12.07.2018 ka analizuar të gjitha shkresat e lëndës të prezantuara nga palët në kontest si dhe vendimin e Departamentit për



Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe pas kësaj ka vërtetuar se vendimi i DMK-së si vendim i shkallës së parë është vendim i drejtë dhe i bazuar në prova konkrete.

Sa i përket pikës së kundërshtimit se në procesverbalin e inspektimit të datës 14.06.2017 është theksuar se njehsori elektrik e ka të ndezur dritën e alarmit, Bordi i ZRRE-së ka analizuar me kujdes shkresat e lëndës dhe gjatë shqyrtimit të tyre, respektivisht procesverbaleve të vet KEDS-it ka hasur në mospërputhje të të dhënave të gjendjes së shpenzimit të njehsorit elektrik nr.16235105. Bordi i ZRRE ka vërejtur se gjendja e shpenzimit të energjisë elektrike në njehsorin elektrik nr.16235105 prej TL=94226 kWh dhe TU=27635 kWh e evidentuar në procesverbalin e inspektimit nr.0724865 të datës 14.06.2017 nuk përputhet me gjendjen e shpenzimit të energjisë elektrike të evidentuar në procesverbalin e ndërrimit të njehsorit elektrik nr.0629205 të datës 14.06.2017, ku gjendja njehsorit elektrik nr.16235105 është TL=96527 kWh dhe TU=29187 kWh. Pra në të njëjtën ditë kemi dy procesverbale të KEDS-it me evidentim ndryshe të gjendjes së shpenzimit të energjisë elektrike të njehsorit elektrik nr.16235105, dhe ai ndryshim është TL=2301 kWh dhe TU=1552 kWh. Mirëpo Bordi i ZRRE-së ka vërejtur se gjendja e shpenzimit të energjisë elektrike në njehsorin elektrik nr.16235105 e evidentuar në procesverbalin e qendrës së kalibrimit nr.org.02, nr.12138 të datës 30.06.2017 është TL=094280 kWh dhe TU=027635 kWh, dhe e cila gjendje përputhet me gjendjen e evidentuar në procesverbalin e inspektimit nr.0724865 të datës 14.06.2017, por jo me gjendjen e shpenzimit të energjisë elektrike të njehsorit nr.16235105 të evidentuar në procesverbali i ndërrimit të njehsorit elektrik nr.0629205 i datës 14.06.2017.

Bordi i ZRRE-së gjithashtu ka analizuar edhe deklaratën e specialisti i daljes, i cili në deklaratën e tij ka theksuar se konsumatorin në fjalë e ka lexuar me rregull dhe me sondë, në muajin e pestë e ka faturuar në vlerë prej 577.77€, dhe se gjatë ndërrimit të njehsorit elektrik nuk e din se si ka ardhur deri te ky borxh. Pra në deklaratën e specialistit të daljes nuk është theksuar se konsumatori ka bërë ndonjë ndërhyrje te pika matëse, madje është theksuar se vazhdimisht është lexuar me rregull dhe me sondë dhe nuk ka informata se si ka ardhur deri te fatura aq e lartë e muajit 06/2017.

Sa i përket pikës së kundërshtimit të paditësit KESCO lidhur me atë se njehsori elektrik gjatë shqyrtimit nga ana e kalibrimit është konstatuar se është në brenda kufijve të matjes, por që ka dritën e alarmit të ndezur, Bordi i ZRRE-së thekson punëtorët e autorizuar të qendrës së kalibrimit me datë 30.06.2017 kanë bërë shqyrtimin e saktësisë së matjes të njehsorit elektrik nr.16235105, ku kanë konstatuar se: njehsori elektrik nuk është në rregull, njehsori nuk është i djegur, njehsori nuk ka dëmtime nga ana e jashtme, njehsori nuk ka probleme me sisteme matëse, njehsori nuk ka probleme me tensione si dhe kanë theksuar se: "Njehsori elektrik dritën e alarmit e ka të ndezur, është ngacmuar me magnet, po nuk dihet ndikimi i magnetit me matje pa e pasur magnetin. Lidhur me këtë Bordi i ZRRE-së thekson se nëse ka ka pasur ndërhyrje të konsumatorit në pikën matëse atëherë KEDS është dashur të filloj procedurën për shfrytëzim të paautorizuar të energjisë elektrike.

Sa i përket pikës së kundërshtimit se nuk duhet të merret parasysh krahasimi i shpenzimit të energjisë elektrike kjo nuk qëndron sepse shpenzimi i energjisë elektrike është indikacion mjaft i rëndësishëm në shqyrtimin e lëndëve të konsumatorëve, dhe se edhe KESCO është bazuar vetëm në procesin e kalibrimit. Bordi i ZRRE-së ka analizuar me kujdes shpenzimin e energjisë elektrike dhe sipas analizës së bërë shpenzimit të energjisë elektrike vërehet se konsumatori ka lexim dhe faturim të rregullt të pikës matëse, përveç faturës nr.0617108925DPE-9002114 të datës 22.06.2017, ku vërehet se në këtë faturë janë faturuar shpenzim prej 25,365 kWh, që është shpenzim shumë më i lartë se shpenzimet e faturuara para dhe pas kësaj periudhe. Bordi i ZRRE-së me qëllim që të paraqet sa me qartë shpenzimet e konsumatorit ka bërë analizimin e konsumit te energjisë së konsumatorit për periudha të njëjta kohore me dy njehsorët elektrik që ka poseduar konsumatori. Shpenzimet mesatare mujore me njehsorin elektrik kontestues nr.16235105 për periudhën 06/2015 deri në periudhën 05/2016 është **4,221.08 kWh/muaj**, si dhe periudhën 06/2016 deri në periudhën 05/2017



mesatarja mujore e shpenzimit është **4,472.00 kWh/muaj**, me njehsorin elektrik nr.67798799 për periudhën 06/2017 deri në periudhën 05/2018 mesatarja mujore e shpenzimit është **5,285.83 kWh/muaj**. Bordi i ZRRE-së bazuar analizat e bëra vërtetohet se shpenzimi i faturuar në faturën nr.0617108925DPE-9002114 të datës 22.06.2017 prej **25,365 kWh** nuk përputhet as përsëafëri me shpenzimin e energjisë elektrike të periudhës para dhe pas periudhës kontestuese. Nga analiza shihet qartë se konsumatori me njehsorin elektrik nr.67798799 nuk ka ndonjë rritje të theksuar të shpenzimit të energjisë elektrike e cila do të duhet të veçohej në krahasim me shpenzimet e energjisë elektrike të konsumatorit me njehsorin e vjetër elektrik nr.16235105 (duke përjashtuar faturën nr.0617108925DPE-9002114 e datës 22.06.2017). Poashtu Bordi i ZRRE-së ka analizuar edhe pajisjet të cilat janë evidentuar në procesverbalin e KEDS-it nr.0724865 të datë 14.06.2017 për të parë se a përputhen shpenzimet e konsumatorit të bëra para dhe pas periudhës kontestuese me pajisjet të cilat janë evidentuar, dhe pas llogaritjeve të bëra rezulton se shpenzimi i energjisë elektrike i evidentuar përmes pajisjeve të evidentuara në procesverbal përputhet me shpenzimin para dhe pas periudhës kontestuese, por jo edhe të shpenzimit të energjisë elektrike të periudhës nr.0617108925DPE-9002114 të datës 22.06.2017.

Bordi i ZRRE gjatë analizimit të të gjitha shkresave të lëndës konstaton se fatura nr.0617108925DPE-9002114 të datës 22.06.2017 nuk paraqet shpenzim real mujor dhe deri të ky faturim ka mundur të jetë si pasojë e ndonjë defekti teknik të pikës matëse. Andaj vendimi i organit të shkallës së parë që KESCO duhet që të shkarkoj konsumatorin me shifër DPR – 9002114 nga fatura nr.0617108925DPE-9002114 të datës 22.06.2017, dhe se për këtë periudhë duhet të ngarkoj konsumatorin me shpenzim prej TL=3636 kWh dhe TU=668 kWh, i cili shpenzim paraqet diferencën e shpenzimit mes faturës së muajit 06/2016 (fatura nr.06160DPE-9002114 të datës 22.06.2016) dhe faturës nr.0617DPE-9002114 të datës 22.06.2017, është vendim i saktë dhe i drejtë.

Bordi i ZRRE, gjithashtu ka konstatuar se përfaqësuesi i autorizuar i KESCO-së në ankesën e tij nuk ka ofruar asnjë provë bindëse për të vërtetuar faktin se vendimi i DMK-së si organ i shkallës së parë nuk është vendim i drejtë dhe i bazuar në ligje dhe rregulla, por që i njëjti në ankesë vetëm se ka kontestuar vendimin e shkallës së parë në mënyrë të përgjithësuar pa ofruar prova të arsyeshme.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 12.07.2018 pas analizimit të krejt asaj që u theksua më lartë, ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

- III. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versionin në gjuhën shqipe.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.



Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i ZRRE-së:

Arsim Janova, u.d. kryesues

Besim Sejfiqaj, anëtar

Selman Hoti, anëtar

Izet Rushiti, anëtar

Vendimi iu dërgohet:

- KESCO-së, dhe
- Konsumatorit A. M. (parashtruar nga B.K.) dhe
- Arkivit të ZRRE-së.